



01 Nr. 439/24 Dt. 18.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Swisscontact dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, 01 nr.212/24, të datës 18.03.2024, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim zhvillimin e sektorit të turizmit-Përditësimi i Strategjisë së Turizmit, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Swisscontact dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, 01 nr.212/24, të datës 18.03.2024, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 3000,00 € (tremijë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Mirëkuptimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Swisscontact dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, 01 nr.212/24, të datës 18.03.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i mallrave dhe shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 348/24 i datës 07.06.2024.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Swisscontact,
 - AKK,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

